



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 10/09/2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik.

Drejtuar: Shoqërisë “**I.D.K - KONSTRUKSION**” sh.p.k, me NUIS K51408016J, me adresë: Rruga Zaja, Koder Berxulle, Vorë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-56859-04-27-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Materiale për sinjalistikë (Tabela)” afati: Brenda 20 (njëzetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 24, Date 04.05.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**2T**” shpk me NUIS K01731001M me ofertë ekonomike **6.072.150** (gjashtë milion e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “**Fredi Electronic**” shpk me NUIS K91803020F me ofertë ekonomike **11.974.000** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**I.D.K – KONSTRUKSION**” shpk me NUIS K51408016J me ofertë ekonomike **13.905.600** (trembëdhjetë milion e nëntëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik “**R.S.M Company**” shpk me Nr.Biznesi 70658046 me seli qendrore Cagllavice Prishtinë dhe me degë të shoqërisë të huaj në Tiranë, Shqiperi me NUIS L04803001U me adresë Rruga Xhorxh Martini dhe me ofertë **9.297.492,5** (nëntë milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik “**SI.SI-AL**” shpk me NUIS K72117030P me ofertë ekonomike **14.958.300** (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë pa tvsh.
6. Operatori ekonomik “**Sings & Road Safety Solutions**” shpk me NUIS L62228020U me ofertë **11.075.970** (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “2T” shpk me NUIS K01731001M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se " *Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 5.994.120 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.*

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. *Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.*

OSE

- b. *Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Operatori ekonomik “2.T” sh.p.k, ka paraqitur 5 (pesë) kontrata punësh publike, të lidhura me Autoritete të ndryshme Kontraktore, ku vlerat e punimeve për zërat e preventivave të paraqitur, siç janë zëri “F.V Tabela sinjalistike” dhe zëra të tjerë të ngjashëm me të është **2.934.600** (dy milion e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh. Kjo vlerë nuk plotëson vlerën e kërkuar në pikën e mësipërme prej **5.994.120** (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH pasi është më e vogël.

- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e kërkuar sipas tabelës së mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim.***

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Tabelë F.80/a Cl.II	Copë	1
2	Tabele F.82/a (shigjetë ishull trafiku majtas) Cl.II	Copë	1
3	Tabelë F.75 (Ndalim qëndrimi) CL.II	Copë	1
4	Panel M6M (Karroatrec) 60x20	Copë	1
5	Tabelë F.303 (Kalim këmbësorësh) 60x60, Cl.II	Copë	1
6	Tabelë F.37 (Stop), A60, Cl.II	Copë	1
7	Tub sinjalistike me H=3.3ML	Copë	1
8	Sinjalizues fotovoltaik për këmbësorët i kompletuar	Copë	1

Nga verifikimi i mostrave të tabelave të paraqitura pranë AK në datën dhe orën e hapjes së ofertave rezulton se adezivi i përdorur është i një prodhuesi të ndryshëm nga ai për të cilin OE ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe skedat teknike. Sqarojmë se adezivi i vendosur në mostër rezulton i prodhuesit “**AVERY DENNISON**” dhe ai për të cilin ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe skedat teknike operatori rezulton “**3M**”, duke sjellë mospërputhje midis mostrës dhe dokumentacionit të paraqitur për adezivin.

2. “Fred Electronic” shpk me NUIS K91803020F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se " *Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 5.994.120 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.*

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.*

OSE

- b) *Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Operatori ekonomik nuk paraqitur kontrata të ngjashme.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi **skeda teknike / katalogë**, ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.", pasi nuk ka paraqitur skedë teknike për zërin "**Sinjalizues fotovoltaiik për këmbësorët i kompletuar**" që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara. Gjithashtu, rezulton se skedat teknike dhe katalogët e paraqitur për tabelat janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me parashikimin e shtojcës 9, pika 1, kriteret e përgjithshme të pranimit /kualifikimit ku thuhet se "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe."
- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e kërkuar sipas tabelës së mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim.**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Tabelë F.80/a Cl.II	Copë	1
2	Tabele F.82/a (shigjetë ishull trafiku majtas) Cl.II	Copë	1
3	Tabelë F.75 (Ndalim qëndrimi) CL.II	Copë	1
4	Panel M6M (Karroatrec) 60x20	Copë	1
5	Tabelë F.303 (Kalim këmbësorësh) 60x60, Cl.II	Copë	1
6	Tabelë F.37 (Stop), A60, Cl.II	Copë	1
7	Tub sinjalistike me H=3.3ML	Copë	1
8	Sinjalizues fotovoltaiik për këmbësorët i kompletuar	Copë	1

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

3. “R.S.M Company” shpk me NUIS L04803001U

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij".

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose nga distributor i autorizuar për zërin “Sinjalizues fotovoltaiik për këmbësorët i kompletuar” dhe zërin “Tub sinjalistike”, zëra të paraqitur në tabelën e shtojcës 12 të dokumentave standarte të tenderit.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi **skeda teknike / katalogë**, ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.”, pasi nuk ka paraqitur skedë teknike për zërin “Sinjalizues fotovoltaiik për këmbësorët i kompletuar” që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara. Gjithashtu, rezulton se skedat teknike dhe katalogët e paraqitur për adezivin dhe tabelat janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me parashikimin e shtojcës 9, pika 1, kriteret e përgjithshme të pranimit /kualifikimit ku thuhet se “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.”
- Nuk përmbush pikën 2.3.6, pika e) të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me ngarkesë mbi 1.5 ton	1	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- b) Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm); e) **çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme)**. Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i ketij prokurimi.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Operatori ekonomik ka marrë me qera mjetin me targë KJ 8736 A nga shoqëria “Xhast” sh.p.k. Mjeti është i pajisur me çertifikatë për transport mallrash **për vete brenda vendit** me Nr.20, datë 25.03.2016 lëshuar nga Bashkia Kavajë në përdorim të personit juridik “Xhast” sh.p.k. Gjithashtu në lejen e qarkullimit, destinacioni i mjetit rezulton për përdorim vetjak.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. **Transport për vete**: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të

veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...].”

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”

Ligji “Për Transportet Rrugore”,bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikata e mjetit me targë KJ 8736 A të cilën e disponon shoqëria “Xhast” sh.p.k., sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete (vetjak) , përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt dhe është dhënë në përdorim në emër të personit juridik “Xhast” sh.p.k, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë “RSM Company” sh.p.k të mallrave me mjetin e sipërcituar të shoqërisë “Xhast” sh.p.k do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e kërkuar sipas tabelës së mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.***

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Tabelë F.80/a Cl.II	Copë	1
2	Tabele F.82/a (shigjetë ishull trafiku majtas) Cl.II	Copë	1
3	Tabelë F.75 (Ndalim qëndrimi) CL.II	Copë	1
4	Panel M6M (Karroatrec) 60x20	Copë	1
5	Tabelë F.303 (Kalim këmbësorësh) 60x60, Cl.II	Copë	1
6	Tabelë F.37 (Stop), A60,Cl.II	Copë	1
7	Tub sinjalistike me H=3.3ML	Copë	1
8	Sinjalizues fotovoltaik për këmbësorët i kompletuar	Copë	1

Nga verifikimi i mostrave të tabelave të paraqitura pranë AK në datën dhe orën e hapjes së ofertave rezulton se adezivi i përdorur është i një prodhuesi të ndryshëm nga ai për të cilin OE ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe skedat teknike. Sqarojmë se adezivi i vendosur në mostrën e zërit 1;2;3;5 të tabelës së mësipërme rezulton i prodhuesit “**AVERY DENNISON**” ndërsa adezivi për të cilin ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe skedat teknike operatori ekonomik, rezulton i prodhuesit “**3M**”, duke sjellë mospërputhje midis mostrës dhe dokumentacionit të paraqitur për adezivin. Gjithashtu mostra për tabelën F.303 (Kalim Këmbësorësh) nuk rezulton e rrethuar nga shiriti i verdhë fosforeshent, klasi 3 (DG3), sipas kërkesës së paraqitur në shtojcën “Specifikimet teknike”.

4. "SI.SI-AL" shpk me NUIS K72117030P

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij" pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për zërin "Sinjalizues **fotovoltaik për këmbësorët i kompletuar**".
- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi skeda teknike /katalogë, ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.", pasi nuk ka paraqitur skedë teknike/katalogë për zërin "Sinjalizues fotovoltaik për këmbësorët i kompletuar".

5. "Sings & Road Safety Solutions" shpk me NUIS L62228020U

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se " *Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 5.994.120 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.*

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.*

OSE

- b) *Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

Operatori ekonomik "Signs & Road Safety Solutions" sh.p.k, ka paraqitur 1 (një) kontratë punë publike, të lidhur me Bashkinë Durrës, ku ka marrë pjesë si bashkim operatorësh ekonomik me shoqërinë "Pepa Group" sh.p.k, në raportin 85 % te punimeve të realizuara nga "Signs & Road Safety Solutions" sh.p.k dhe 15% nga "Pepa Group" sh.p.k. Nisur nga vlerat e punimeve të kryera nga "Signs & Road Safety Solutions" sh.p.k, sipas përqindjes së mësipërme rezulton se zëri "F.V Tabela sinjalistike..." është 1.486.659 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh. Kjo vlerë nuk plotëson vlerën e kërkuar në pikën e mësipërme prej **5.994.120** (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH pasi është më e vogël. Gjithashtu OE nuk ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Durrës për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se " *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar*

për mallin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij".

Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi për zërin **“Sinjalizues fotovoltaik për këmbësorët i kompletuar”** nga kompania Tamburrini Alessandro. Kjo shoqëri ka lëshuar edhe një deklaratë ku shprehet se është e autorizuar të shes këtë produkt në Itali dhe Shqipëri, por pa përmendur se cili prodhues e ka autorizuar. Gjithashtu në skedën teknike nuk identifikohet emri i prodhuesit të mallit. Nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë dokument nga ana e prodhuesit të këtij produkti që ti japë të drejtën kompanisë Tamburrini Alessandro të shesë mallrat e tij, duke mos vërtetuar lidhjen midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

- Nuk përmbush pikën 2.3.6, pika e) të kapacitetit teknik ku parashikohet se "Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me ngarkesë mbi 1.5 ton	1	Pronësi ose me qira

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) **certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme)**. Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

Operatori ekonomik ka marrë me qera mjetin me targë AA 589 MS nga shoqëria “Alko Impex General Construction” sh.p.k. Mjeti është i pajisur me certifikatë për transport mallrash **për vete** brenda vendit me Nr.31299/4, datë 14.10.2016 lëshuar nga Bashkia Tiranë në përdorim të personit juridik “Alko Impex General Construction” sh.p.k. Gjithashtu në lejen e qarkullimit, destinacioni i mjetit rezulton për përdorim vetjak.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. **Transport për vete:** transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. **Transport për të tretë dhe me qira:** transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”

Ligji “Për Transportet Rrugore”,bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë

transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikata e mjetit me targë AA 589 MS të cilën e disponon shoqëria “Alko Impex General Construction” sh.p.k, sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete (vetjak), përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt dhe është dhënë në përdorim në emër të personit juridik “Alko Impex General Construction” sh.p.k sh.p.k, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë “Signs & Road Safety Solutions” sh.p.k të mallrave me mjetin e sipërcituar të shoqërisë “Alko Impex General Construction” sh.p.k do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e kërkuar sipas tabelës së mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim.*

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Tabelë F.80/a Cl.II</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
2	<i>Tabele F.82/a (shigjetë ishull trafiku majtas) Cl.II</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
3	<i>Tabelë F.75 (Ndalim qëndrimi) CL.II</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
4	<i>Panel M6M (Karroatrec) 60x20</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
5	<i>Tabelë F.303 (Kalim këmbësorësh) 60x60, Cl.II</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
6	<i>Tabelë F.37 (Stop), A60, Cl.II</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
7	<i>Tub sinjalistike me H=3.3ML</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
8	<i>Sinjalizues fotovoltaik për këmbësorët i kompletuar</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Operatori ekonomik “I.D.K – KONSTRUKSION” shpk me NUIS K51408016J, me adresë Rruga Zaja, Koder Berxulle, Vorë, Tiranë, dhe me ofertë ekonomike **13.905.600** (trembëdhjetë milion e nëntëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga 5 Maji, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 11.06.2020.

Ankesa: Ka më datë: 04.05.2020.

Ka marrë përgjigje më datë: 06.05.2020.

Ankesa: Ka më datë: 18.06.2020.

Ka marrë përgjigje më datë: 24.06.2020.